XII. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.
- Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për Leje Mjedisore Komunale hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr.1796-5, 6, 7, 8, 15, 21 & 26; 1797-3, 29, 30, 31, 33, 38, 41, 65 & 66 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasit 3" dhe "Rrugë", paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do të ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=2,922 + 4,256=7,178m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIV. Pagesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë;

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit;

XV. Vlefshmëria e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me të drejtë vazhdimi edhe për një (1) vit tjetër, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së kushteve ndërtimore.

Ar sy e t i m

Kërkuesit: Pronarët, Shefqet Çerkini, Ismajl Hoxha, Skender Haliti, Agim Selmani, Kushtrim, Driton & Sanije Bajgora, Ramadan & Albana Seferi, "In On" sh.p.k, Labinot Shahini, Adnan Hysejri, Driton Gërdovci, Hazbi & Shafi Canolli, Hafije Qyqalla, Malush Nuhiu, Emrush Helshani, Gani & Avni Thaçi, Jakup Haxhiu, Muhamedteki Hysejri, Remzije Mehmeti, Jeton, Driton, Nazmije, Veton & Faton Canolli, nga Prishtina, dhe Investitorit "IN ON" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810837685, dhe me përfaqësues Besnik Thaqi nga Prishtina, me kërkesën 05nr.350/03-

224384/23 dt. 22.11.2023, kanë kërkuar nga kjo drejtori, *ndryshim-plotësim dhe zgjerim* të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-138737/22 dt.13.02.2023, të caktuara nga kjo drejtori, përkatësisht për përfshirjen në trajtim të parcelave tjera kadastrale, dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e **Kompleksi "IN ON – 3"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "A" me 2B+S+P+12 & "B" me 2B+S+P+13, në lokacionin e përkthyer në pikën I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesë për kushte ndërtimore, 05nr.350/03 -224384/23 dt.22.11.2023, dhe plotësuar me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/03 – 2202/24 dt. 08.02.2024, dhe gjatë fazës së trajtimit është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshminë mbi pronësinë: Kopjet e planit & certifikatat e pronësisë për parcelat kadastrale: nr. 1796-3, 5, 6, 7, 8, 15, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 & 26; nr.1797-3, 6, 7, 8, 9, 19, 29, 30, 31, 33, 38, 39, 41, 43, 65, 66 & 67 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtorja e Kadastrit;*
- *Projekt propozimin konceptual – "zgjidhjen urbane" me projektin ideor, hartuar nga "IN ON"sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810837685, me pronar Besnik Thaqi dhe me projektues Ma.Sc.ark. Arjeta Nuredini;*
- *Certifikatën e regjistrimit të "IN ON"sh.p.k. nga Prishtina, me numër unik ARBK nr.810837685;*
- *Incizimin gjeodezik të lokacionit dhe rrethinës, punuar nga Kompania gjeodezike "Geo-Group" sh.p.k nga Prishtina, me numër të licencës nr.52;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", me numër unik ARBK nr.810837685 të lidhur në mes të Driton & Kushtrim Bajgora, dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.9520/2023 dhe Ref.4527/2023 dt.27.10.2023;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Emrush Helshani, Sevdije Helshani dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.2300/2022 dhe Ref.683/2022 dt.18.02.2022;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", të lidhur në mes të Ismajl Hoxha e Emine Hoxha dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, me numër unik ARBK nr.810837685 përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.7438/2023 dhe Ref.3560/2023 dt.25.08.2023;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtim e përbashkët", të lidhur në mes të Skender Haliti e Nifa Haliti përfaqësuar nga Ahmet Haliti dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, me numër unik ARBK nr.810837685 përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.8374/2023 dhe Ref.3946/2023 dt.22.09.2023;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtim e përbashkët", të lidhur në mes të Agim Selmani e Valbona Selmani dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, me numër unik ARBK nr.810837685 përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.8580/2023 dhe Ref.4041/2023 dt.28.09.2023;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Sanije Bajgora dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.9352/2023 dhe Ref.4448/2023 dt.23.10.2023;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Malush Nuhiu e Aferdita Nuhiu dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.13275/2021 dhe Ref.3502/2021 dt.30.08.2021;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Jakup Haxhiu e Bahrije Haxhiu dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.14422/2021 dhe Ref.3873/2021 dt.20.09.2021;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Avni Thaqi e Pranverë Thaqi dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.13455/2021 dhe Ref.3545/2021 dt.01.09.2021;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Gani Thaqi e Pranverë Thaqi dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.14096/2021 dhe Ref.3793/2021 dt.14.09.2021;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së paluajtshmërisë në investitorin, me dorzani", të lidhur në mes të Ramadan Seferi e Albana Miftari Seferi dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.4243/2023 dhe Ref.2055/2023 dt.26.05.2023;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së paluajtshmërisë në investitorin, me dorzani", të lidhur në mes të Labinot Shahini dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë,*

me LRP.4242/2023 dhe Ref.2054/2023 dt.26.05.2023;

- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", të lidhur në mes të Muhamedteki Hysejani e Thaura Hysejani & Adnan Hysejani e Shkëndije Loxha Hysejani dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.1397/2023 dhe Ref.573/2023 dt.14.02.2024;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Hazbi Canolli e Shafi Canolli (të përfaqësuar nga Arton Mehmeti) dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.1633/2021 dhe Ref.422/2021 dt.08.02.2021;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Remzije Mehmeti e Arton Mehmeti dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.1625/2021 dhe Ref.416/2021 dt.08.02.2021;
- Akti noterial "Kontratë për shitje blerje të patundshmërisë", të lidhur në mes shitësve si në vijim: Jeton Canolli, Driton Canolli, Nazmije Canolli Fejzullahu, Veton Canolli e Faton Canolli dhe blerësi ne vijim: Investitori "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.2215/2024 dhe Ref.946/2024 dt.13.03.2024;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Driton Gërdovci (i përfaqësuar nga Arton Zhubi) dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.5839/2022 dhe Ref.1879/2022 dt.16.05.2022;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore", të lidhur në mes të Shefqet Çerkini e Suzana Çerkini dhe Investitorit "In On" sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.1594/2021 dhe Ref.1879/2022 dt.16.05.2022;
- Kopjet e letërnjoftimit-dokumenteve të identifikimit të pronarve dhe investitorit;
- Fotot e lokacionit;
- Shkresa "Njoftim Publik" nga data 18.01.2024 gjerë 01.02.2024, lëshuar nga kjo drejtori;
- Fotot e "Njoftimit Publik";
- Shkresa "Ftesë" e datës 05.01.2024;
- Shkresa "Ftesë" e datës 05.04.2024 (gabim shënuar 05.01.2024);
- Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave punuar nga Kompania gjeodezike "Geo-Group" sh.p.k nga Prishtina, me numër të licencës nr.52;
- Shkresa "Procesverbal", i datës 15.01.2024;
- Shkresa "Procesverbal", i datës 15.04.2024;
- Procesi verbal i mbledhjes së organit kolegjal këshillëdhënës për shqyrtimin e Kushteve dhe Lejeve ndërtimore, i mbajtur me dt. 15.02.2024
- Shkresa përmes postës elektronike e datës 24.01.2024, dërguar nga Driton dhe Kushtrim Bajgora.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për për **ndryshim-plotësim** dhe **zgjerim** të kushteve ndërtimore, 05nr.350/03-224384/23 dt.22.11.2023, dhe plotësuar me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/03 – 2202/24 dt.08.02.2024, dokumentacionit të bashkangjitur, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për lokacionin ku shtrihen parcelat - Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe projekt propozimit – Projektit konceptual me "zgjdhja urbane" & projektit ideor të prezantuar, si dhe konsultimit të dosjes së lëndës 05nr.350/02 – 138737/22 dt.17.06.2022, ka konstatuar se:

Paraprakisht, kjo drejtori, bazuar në kërkesën për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 138737/22 dt.17.06.2022, kjo drejtori, me Vendim 05nr.350/02 – 138737/22 dt.13.02.2023, ka caktuar kushtet ndërtimore në emër të kërkuesve: Pronarëve, Driton Gërdovci, Hazbi dhe Shafi Canolli, Hafije Qyqalla, Remzije Mehmeti nga Prishtina dhe Investitorit "IN ON" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810837685, dhe me përfaqësues Besnik Thaqi nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksit "IN ON – 3"** me ndërtesë shumë banesore & afariste, me 2B+P+8, në kuadër të Parcelës ndërtimore "C-2-2" të Bllokut urban "C-2" të Tërësisë "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, nr.1797-8, 1797-9, 1797-19 & 1797-43 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual të prezantuar;

Kërkuesit: Pronarët, Shefqet Çerkini, Ismajl Hoxha, Skender Haliti, Agim Selmani, Kushtrim, Driton & Sanije Bajgora, Ramadan & Albana Seferi, "In On" sh.p.k, Labinot Shahini, Adnan Hysejani,

Driton Gërdovci, Hazbi & Shafi Canolli, Hafije Qyqalla, Malush Nuhiu, Emrush Helshani, Gani & Avni Thaçi, Jakup Haxhiu, Muhamedteki Hysejini, Remzije Mehmeti, Jeton, Driton, Nazmije, Veton & Faton Canolli, nga Prishtina, dhe Investitorit "IN ON" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810837685, dhe me përfaqësues Besnik Thaqi nga Prishtina, , me kërkesën 05nr.350/03 - 224384/23 dt.22.11.2023, kanë kërkuar nga kjo drejtori, **ndryshim-plotësim dhe zgjerim** të Vendimit të kushteve ndërtimore, 05nr. 350/02-138737/22 dt.13.02.2023, të caktuara nga kjo drejtori, përkatësisht për përfshirjen në trajtim të parcelave tjera kadastrale, dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksi "IN ON – 3"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "A"** me 2B+S+P+13 & **"B"** me 2B+S+P+14, në kuadër të Parcelave ndërtimore "C-1-3", "C-1-4", "C-2-1" dhe "C-2-2", të Bllokut urban "C-1" & "C-2", të Tërësisë Urbane "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në parcelave kadastrale, nr. 1796-3, 5, 6, 7, 8, 15, 17,19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 & 26; nr.1797-3, 6, 7, 8, 9, 19, 29, 30, 31, 33, 38, 39, 41, 43, 65, 66 & 67 ZK Prishtinë, duke prezantuar edhe projekt propozimin konceptual me Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe të cilën kërkesë kjo drejtori e ka marrë në trajtim.

Pas pranimit të kërkesës për kushte ndërtimore, në fazën fillestare të saj, në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 18.01.2024 ka vendosur Afishen "Njoftimi publik" e cila ka qëndruar gjer me datë 01.02.2024, ku sipas rregullativës ligjore të lartcekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës duhet të informohet me synimin e kërkuarve dhe ofrimin e mundësisë për dhënien e komenteve të pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m'.

Pas analizës së projektit konceptual me Planin e situacionit – "zgjidhja urbane", dhe krahasimit të tij në raport me kriteret e pjesës grafike të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", konkretisht hartës së riparcelimit, është konstatuar se në kuadër të parcelës ndërtimore "C-1-3", të bllokut urban "C-1", përkatësisht brenda vijës rregulluese të asaj pjese të bllokut, përfshihen edhe pjesë të parcelave kadastrale nr.1797-32 & 1797-34 ZK Prishtinë, të cilat nuk janë përfshirë në trajtim në këtë zgjidhje urbane të propozuar, dhe me qëllim të sigurimit të një zgjidhjeje urbane më funksionale dhe mundësimin e zhvillimit edhe të atyre pronave, të njëjtat parcela duhet të përfshihen në trajtim në kuadër të këtij blloku. Andaj, duke u bazuar në nenin 83, 109 dhe 116 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes shkresave "Ftesë" të datës 05.01.2024, janë ftuar në takim pronarët e parcelave kadastrale të referuara, për tu njoftuar me propozimin për kushte ndërtimore, të prezantuar me kërkesë. Në takimin e caktuar për datën 15.01.2024, në ora 10.00, bazuar në procesverbalin e mbajtur, e i cili është pjesë e dosjes së lëndës, të ftuarit nuk janë paraqit në zyrat e drejtorisë (edhe pas pritjes prej ~25min.), në takim kanë prezantuar vetëm investitori dhe projektuesi.

Më tutje, në procedurën e shqyrtimit dhe analizimit të mëtejme të kërkesës, në raport me rregullativën ligjore në fuqi dhe dokumentin e planifikimit hapësinor - Planin Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", është konstatuar se në kuadër të Parcelës ndërtimore "C-1-4" dhe "C-2-1" përfshihen edhe parcelat kadastrale nr.1794-4 & 1794-5 ZK Prishtinë. Andaj, duke u bazuar në rregullativën e njëjtë ligjore në fuqi, përmes shkresës "Ftesë" të 05.04.2024 (është shënuar gabim 05.01.2024), janë ftuar në takim pronarët e parcelave kadastrale të referuara, për tu njoftuar me propozimin për kushte ndërtimore, të prezantuar. Në takimin e caktuar për datën 15.04.2024, në ora 10.00, bazuar në procesverbalin e mbajtur, e i cili është pjesë e dosjes së lëndës, të ftuarit nuk janë paraqit në zyrat e drejtorisë (edhe pas pritjes prej ~45min.), në takim përsëri kanë prezantuar vetëm investitori dhe projektuesi;

Pas zhvillimeve të përshkruara si më lartë, kjo drejtori ka vazhduar procedurën për shqyrtimin e kërkesës, duke marrë në rishqyrtim edhe një herë projekt propozimin konceptual të prezantuar, dhe në bashkëveprim me projektuesin dhe investitorin, të njëjtin e ka analizuar, dhe ka konstatuar se "zgjidhja urbane" është konceptuar të zhvillohet në dy grupe / faza të realizimit: **Grupi / Faza "A"** & **Grupi / Faza "B"**, në kuadër të Parcelave ndërtimore "C-1-3", "C-1-4", "C-2-1" & "C-2-2", me trajtim të parcelave kadastrale nr.1796-3, 5, 6, 7, 8, 15, 17,19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 & 26; nr.1797-

3, 6, 7, 8, 9, 19, 29, 30, 31, 33, 38, 39, 41, 43, 65, 66 & 67 ZK Prishtinë, si dhe me analizë të parcelave kadastrale nr.1797-4 & 5; nr.1797-14, 16, 18, 21, 23, 32, 63 & 64 ZK Prishtinë (për Grupi/Faza "B").

Për Grupi / Faza "A", në kuadër të Parcelave ndërtimore "C-1-3", "C-1-4", "C-2-1" & "C-2-2", është planifikuar realizimi / ndërtimi i ndërtesave shumë banesore & afariste - Ndërtesa "A" me 2B+S+P+13 & "B" me 2B+S+P+14, sipas kriterëve dhe parametrave urban të përcaktuar sipas planit rregullues.

Ndërsa, për Grupi / Faza "B" të realizimit, pronarët dhe investitori potencial do të aplikojnë me kërkesë për caktimin e kushteve ndërtimore, bazuar në analizën e bërë në këtë zgjidhje urbane, të miratuar, sipas përshkrimit në paragrafin V. *Plani i situacionit*, të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjithashtu, para aplikimit për leje ndërtimore, aplikuesit dhe investitori, duhet të përfundojnë procedurën e rregullimit të parcelës ndërtimore, përkatësisht përfundimin e procedurës së ndarjes, bashkimit dhe shpronësimit / kompensimit, të pjesëve dhe parcelave kadastrale të trajtuara, sipas përshkrimit në paragrafin VII, VIII dhe IX, të dispozitivit të këtij vendimi.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, është konstatuar rregullësia e Planit të situacionit – "zgjidhja urbane" dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçe të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, me rrugën në e planifikuar të planit rregullues si dhe e njëjtat me rrugët tjera të planit, ku ndër të tjera konstatohet:

"Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të "In On" shpk., në lagjen "Prishtina e Re, Zona Perëndim", Prishtinë, lidhur me kërkesën për plotësim dhe ndryshim të kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/03-224384/23 të dt.22.11.2023, kyçjet për automjete në rrugën e planifikuar te paraparë me planin rregullues "Prishtina e Re, Zona Perëndim" për ndërtesën "A" me etazhitet 2B+S+P+12, dhe ndërtesa "B" me etazhitet 2B+S+P+13, sipas zgjidhjes së prezantuar mund të pranohet si e tillë, marrë parasysh hapësirën e kësaj zgjidhje urbane dhe shmangien e kyçjeve në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimi në Bashkëpronësi", "Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës" dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Kyçjet duhet të harmonizohen dhe të përshtaten me profilin e rrugës së planifikuar dhe në kohën kur realizohet ajo sipas planit, si dhe të ruhet profili i tërthorë i rrugës së planifikuar".

Gjithashtu në fund të trajtimit të projekt propozimit konceptual, Komisioni këshillëdhënës formuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës 14nr.020/04 – 275630 dt.27.12.2022 për shqyrtimin e kushteve ndërtimore, pas analizimit të projekt-propozimit të prezantuar nga përfaqësuesit e aplikuesit / investitorit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, nga projektuesi i investitorit, me datë 15.02.2024, përmes procesverbalit ka konstatuar disa vërejtje të cilat në ndërkohë janë korrigjuar.

Pas konstatimeve të lartshënuara, dokumentacionit të shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, është konstatuar se, bazuar në nenin 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", është prezantuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe "zgjidhja urbane" e propozuar është në harmoni me kriteret e planit rregullues urban, andaj u vendos që kërkesa për *ndryshim-plotësim* dhe *zgjerim* të Vendimit të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02-138737/22 dt.13.02.2023, përkatësisht për përfshirjen në trajtim të parcelave tjera kadastrale, në emër të kërkuesve: Pronarëve, Shefqet Çerkini, Ismajl Hoxha, Skender Haliti, Agim Selmani, Kushtrim, Driton & Sanije Bajgora, Ramadan & Albana Seferi, "In On" sh.p.k, Labinot Shahini, Adnan Hysejri, Driton Gërdovci, Hazbi & Shafi Canolli, Hafije Qyqalla, Malush Nuhiu, Emrush Helshani, Gani & Avni Thaçi, Jakup Haxhiu, Muhamedteki Hysejri, Remzije Mehmeti, Jeton, Driton, Nazmije, Veton & Faton Canolli, nga Prishtina, dhe Investitorit "IN ON" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810837685, dhe me përfaqësues Besnik Thaçi

nga Prishtina, të miratohet me këtë vendim, dhe të ricaktohen kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin **Kompleksi "IN ON – 3"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "A"** me 2B+S+P+13 & **"B"** me 2B+S+P+14, në kuadër të Parcelave ndërtimore "C-1-3", "C-1-4", "C-2-1" dhe "C-2-2" të Bllokut urban "C-1" & "C-2" të Tërësisë "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër dhe me trajtim të parcelave kadastrale: nr. 1796-3, 5, 6, 7, 8, 15, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 & 26; nr. 1797-3, 6, 7, 8, 9, 19, 29, 30, 31, 33, 38, 39, 41, 43, 65, 66 & 67 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual dhe "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

*Gjithashtu, përmes shkresës, "Njoftim" 05nr.350/03 – 224384/23 dt.03.05.2024, kjo drejtori vendosi që bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në dokumente publike, palët e interesuara – pronarin / poseduesin e parcelës kadastrale nr.1797-4, 1794-5, 1797-32 & 1797-34 ZK Prishtinë, ti informojë se, kjo drejtori me Vendim 05nr.350/02 – 138737/22 dt.03.05.2024, ka ri-caktuar kushtet ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksit "IN ON – 3"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "A"** me 2B+S+P+13 & **"B"** me 2B+S+P+14, në kuadër të Parcelave ndërtimore "C-1-3", "C-1-4", "C-2-1" dhe "C-2-2" të Bllokut urban "C-1" & "C-2" të Tërësisë urbane "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër dhe me trajtim të parcelave kadastrale: nr. 1796-3, 5, 6, 7, 8, 15, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 & 26; nr. 1797-3, 6, 7, 8, 9, 19, 29, 30, 31, 33, 38, 39, 41, 43, 65, 66 & 67 ZK Prishtinë;*

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidha urbane" e **Kompleksit "IN ON – 3"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "A"** me 2B+S+P+13 & **"B"** me 2B+S+P+14, në kuadër të Parcelave ndërtimore "C-1-3", "C-1-4", "C-2-1" dhe "C-2-2" të Bllokut urban "C-1" & "C-2" të Tërësisë urbane "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë; Situacioni i parcelave kadastrale me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, dhe Manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group" sh.p.k nga Prishtina, me numër të licencës nr.52.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet: Kërkuarve/invesitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndëve, 05nr.350/02 – 224384/23 dt.22.11.2023 & 05nr.350/02-138737/22 dt.17.06.2022.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 138737/22 DT.03.05.2024

Zyrtarë:
Ergyn Hajredini,

Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi,





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo


Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01

Vija Rregulluese sipas PRRL	11 7513004.86 4722336.44	22 7513073.53 4722357.75	33 7512949.99 4722395.79	43 7513002.77 4722379.13	54 7513007.12 4722341.35
1 7512878.03 4722401.11	12 7513012.44 4722334.31	23 7513063.45 4722363.09	34 7512939.81 4722396.49	44 7513015.83 4722375.21	55 7512983.20 4722346.77
2 7512878.14 4722342.37	13 7513026.67 4722329.59	24 7513050.88 4722369.37	35 7512919.19 4722398.07	45 7513026.55 4722371.46	56 7512959.39 4722348.56
3 7512900.30 4722344.91	14 7513033.12 4722327.58	25 7513037.41 4722375.27	36 7512878.04 4722393.59	46 7513040.52 4722365.82	57 7512955.14 4722348.88
4 7512904.37 4722345.15	15 7513052.47 4722321.54	26 7513025.82 4722379.71	Vija Ndërtimore sipas PRRU	47 7513052.00 4722360.51	58 7512942.10 4722350.07
5 7512918.29 4722345.67	16 7513055.61 4722320.26	27 7513015.48 4722383.20	37 7512949.44 4722388.31	48 7513059.94 4722356.47	59 7512914.36 4722350.77
6 7512941.81 4722345.07	17 7513058.17 4722318.64	28 7513000.42 4722387.51	38 7512957.09 4722387.64	49 7513072.00 4722350.07	60 7512899.87 4722349.89
7 7512955.16 4722343.87	18 7513059.32 4722317.69	29 7512986.84 4722390.66	39 7512961.20 4722387.20	50 7513064.63 4722319.43	61 7512878.13 4722347.48
8 7512959.15 4722343.57	19 7513061.17 4722315.78	30 7512973.86 4722393.02	40 7512974.12 4722385.38	51 7513061.14 4722322.67	
9 7512982.46 4722341.82	20 7513063.67 4722311.87	31 7512961.56 4722394.70	41 7512984.63 4722383.46	52 7513054.28 4722326.21	
10 7512999.33 4722337.99	21 7513070.70 4722343.51	32 7512957.57 4722395.13	42 7512994.99 4722381.14	53 7513028.20 4722334.35	





Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosova

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjetit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostorog
 Agency for Spatial Planning and Urban Planning / Ministry of Environment and Spatial Planning

AGENCIJA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVË / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë


Loji / mjeshë kadastre e Vrasitarske jedinice: Parcelë

Nr. i njësive kadastrale / Br. kadastrske jedinice: _____

Nr. i njësive kadastrale / Br. kadastrske jedinice: _____

Propozim për ndarje dhe bashkim të parcelave: 01796-3, 5, 6, 7, 8, 15, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 01797-3, 6, 7, 8, 9, 19, 29, 30, 31, 33, 38, 39, 41, 43, 65, 66, 67.

Nr	Y	X
1	7512878.107	4722359.360
2	7512878.097	4722364.365
3	7512884.876	4722400.601
4	7512895.860	4722399.790
5	7512904.891	4722399.123
6	7512957.653	4722396.878
7	7512957.574	4722395.132
8	7512957.054	4722384.090
9	7512957.044	4722383.880
10	7512955.896	4722359.489
11	7512955.675	4722354.799
12	7512905.512	4722345.195
13	7512904.370	4722345.153
14	7512900.300	4722344.907
15	7512888.033	4722343.504
16	7512959.624	4722353.625
17	7512959.844	4722358.308
18	7512961.035	4722383.602
19	7512961.057	4722384.056
20	7512961.558	4722394.704
21	7512961.664	4722396.965
22	7512982.858	4722391.449
23	7512993.065	4722389.302
24	7513000.784	4722337.656
25	7513005.774	4722336.524
26	7513026.672	4722329.593
27	7513027.064	4722329.471
28	7513053.213	4722321.296
29	7513056.034	4722320.030
30	7513059.306	4722317.700
31	7512977.557	4722392.412
32	7512982.858	4722391.449
33	7512987.971	4722390.422
34	7512993.063	4722389.303



Rilievi / Shtimio: Geo-Group Sh.p.k
 (emri dhe mbiemri i gjeneralit/kompanisë/line i prezantimit gjeodez/kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 5P

Nënskrimi / Potpis:

Data e rilievimit / Datum snimanja: 03.04.2024



- Sip. Brenda vijës rregulluese - Faza A
- Sip. Brenda vijës rregulluese - Faza B
- Sip. për shpronësim - Faza A
- Sip. për shpronësim - Faza B
- Sip. për fazë tjetër

Shpjegues